



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK FIER**

Nr 470 Prot

Fier më, 12.2021

Lënda: Njoftim për levizje paralele .

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBESHTETËSE
DREJTORISË SË MARDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.**

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” ; të ligjit nr 15/2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë “; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive “ ; të udhëzimit nr 14 datë 27.05.2021 “ Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarinë e ofruesve public të arsimit dhe formimit profesional”.

Ofruesi publik i AFP-së Drejtorisë Rajonale të Ofritit Formimit Profesional Publik Fier , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

- Instruktor/e per kursin Kuzhine (Berat) 1 person
- Instruktor/e per kursin Mobileri (Fier) 1 person

2. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- g) Të ketë zotësi të plotë për të vëpruar;
- h) Të jetë në kushtë shëndetësorë që e lejojnë të kryesj detyrën
- i) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- j) Të mos ket ndaj tij masa disiplinore që nuk jan shuar.
- k) Te demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit.
- l) Të demostrojë aftësi të punës ne grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- c) Të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesmës në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
- d) të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit

2. Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lire, duhet të përfshijë.

- letermotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në)
- kartën e identitetit
- diplomë
- librezë e punës
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim i gjendjes shëndetësore
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
- dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
- dokumentat në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofrimit të AFP-së brenda

date...17...12. 2021

DREJTORI

Aleksander Lajçi

